REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 309/20
Datë/Datum. 18.05.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E ARSIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	**208 Udheheqesi – 19-7223-1-1-1**
Nr i brendshëm	**208019060111**

Sa i përket tenderit për **FURNIZIM ME INVENTAR NË SHKOLLAT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*
NTSH „DELFINA" MALISHEVË

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

HYSNI MAZREKU

(Adresa)

MALISHEVË *24000*
(Vendi) *(Kodi postar)*

049-806-117

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

BEKIM MAZREKU

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
delfinaa@live.com

(Adresa elektronike)

16.05.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi i ankuesit)*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Permes e-prokurimit me datë **23.09.2019***është publikuar njoftimi per kontratë. Me datë 18.10.2019 në oren 14:00h është bërë hapja e ofertave dhe ne ofertim kanë marrë pjesë pesë (5) OE. Me daten 18.11.2019 shpallet njoftimi per dhenje te kontrates dhe marrim leter standarde per tenderuesin e PAsuksesshem. Me date 04.12.2019 behet* **njoftim për pezullimin e aktivitetit të prokurimit, Me daten 07.02.2020 behet anulimi i aktivitetit të prokurimit „PA TË DREJTË TË ANULIMIT"**

Arsyet e eleminimit te ofertes tonë janë shkelje të rënda të LPP në fuqi .
Me date 19.02.2020 bejm ANKESE ne OSHP dhe lenda kthehet ne RIVLERSIM.

Me datë 30.04.2020 behet ngritja e vendimit ku ne marrim LETER STANDARDE PER TENDERUESIN E PASUKSESSHEM.
Me kete vendim AK ben shkelje te renda te LPP-se duke e shpallur si tenderues i sukseshem një

grup të OE i cili nuk i ka plotesuar kerkesat e dosjes se tenderit..

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] Jo [ ]

Ofertat janë dorzuar me datë 18.10.2019 ne ora 14:00h dhe me pas eshte ber hapja publike ku kemi marre pjese . Kemi marre procesverbalin e hapjes se ofertave ne kopje elektronike. Ne procesverbalin e hapjes nuk ka pase verejteje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Me datë 05.05.2020 (per herë të dytë) kemi bërë Kerkesë për Rishqyrtim të vendimit të AK mirëpo Kerkesa jonë refuzohet pa arsye.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit të ketij aktivitei te prokurimit konkretisht gjatë procesit të vlersimit të tenderëve ka bere shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.04/L-042 per Prokurim Publik të Republikes se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr.04/"-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092.

- **AK ka shkelur nenin 1,6, 7, 59.4, të LPP të amandamentuar.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1.
Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes fitues të një grupi të OE të papergjeshëm nga aspekti i kerkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë për ketë aktivitet te prokurimit ka bere shkeljen e LPP ne fuqi per arsye se nuk ka pasur të drejtë të shpërblej me kontratë grupin i cili nuk i ka plotësuar kerkesat e dosjes së stenderit dhe te njoftimit per kontrate të bërë nga AK.

Kerkesat që nuk janë plotesuar janë :

1. QERTIFIKATË EN.1729-1, 2015 EN1729-2 2012+A1 2015 -Kjo eshte kerkesa e AK e cekur ne dosjen e tenderit e cila qertifikate eshte vetem per **KARRIG SHKOLLORE GRUPI I KATERT** (parauniversitar) – OE i shpallur fitues nga AK nuk e ka plotesuar kete kerkese.
2. QERTIFIKATË EN.1729-1 2015 EN1729-2 2012+A1 2015 -Kjo eshte kerkesa e AK e cekur ne dosjen e tenderit e cila qertifikate eshte vetem per **BANKË SHKOLLORE GRUPI I KATERT** (parauniversitar) – OE i shpallur fitues nga AK nuk e ka plotesuar kete kerkese.

Sqarim : OE i shpallur fitues nga AK i ka ofruar dy certifikata të cilat sikur të ishin në një certifikat të vetme do të ishin për karrig ose për bankë . KËTO CERITIFKATA NUK I PLOTËSOJN KËRKESAT E AK-së.

Qertifikatat duhet te jenë sikur modeli qe ne po ia bashkangjesim AKESES sonë (qertifikatat tona) dhe keto qertifikata e plotesojn kerkesen e AK-se.

Pretendimi 2.
Në përshkrimin e çmimeve (paramasë). disa nga çmimet për njësi, janë të padukshme PROVE : LETER STANDARDE PER TENDERUESIN E ELEMINUAR e dates 18.11.2019.

1. **ÇMIMI I PADUKSHEM ËSHTË NË POZICIONIN nr.30**
   Dollap me rrota me 3 sirtar / administrate , bibloteke , dhoma e mesuesve .
   Te ky pozicion çmimi per njësi është i padukshëm (Sasia eshte cope 36 çmimi per njesi i padukshem ndersa totali është 1080).

Për këtë pozicion AK nuk mund te vendos se eshte i plotesuar siq duhet per arsye se nuk shifet.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë ne si grup i OE kerkojm :
nga paneli shqyrtues i OSHP-së që ankesen tonë ta e pranoj si të bazuar dhe këtë procedur ta e kthej në rivlersim në menyrë që AK të ketë mundesi të i eleminoj shkeljet e bera dhe ne te shpallemi fitues të ketij aktiviteti të prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale që na shkaktohen nese nuk e marrim ketë kontratë janë të konsiderueshme si në fushen financiare, fitime te munguara, rishikim te stafit te angazhuar dhe mosmundesi e kompenzimit te shpenzimeve pergatitore per kete kontrate.
Po ashtu kemi edhe demtim te reputacionit si ndermarrje prodhuese me nje pervoj te madhe të prodhimit te mobiljeve.
Keto sepse pas publikimit te njoftimit per kontrate ne si grup OE i kemi bere te gjitha pergatitjet teknike dhe profesionale per gjithë periudhen e parapare ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit dhe kemi pasur shpenzime te konsiderueshme.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohesisht një kopje do t'ia dërgoje në mënyren më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*